



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:105099  
Datë: 22.05.2024  
Numri i dokumentit: 05717229

**P.nr.2023:105099**

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC**, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit Xh.M, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, ndërsa sipas aktakuzës PP/II.nr.1393/22 të dt.08.05.2023, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt. 10.05.2024, ku prezent ishin Prokurorja e shtetit Uridia Caka dhe i akuzuari Xh.M, me dt.13.05.2024, shpallë, ndërsa me dt. 22.05.2024, e përpilon këtë:

## AKT GJYKIM

**I AKUZUARI: Xh.M**, nga i ati S dhe e ëma F e lindjes Th i lindur më datën ..., në fshatin Ratkoc komuna e Rahovecit, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas R së Kosovës, i martuar, i ati i 2 fëmijëve, ka të kryer katër vite të shkollës fillore, pensioner , i gjendjes së dobët ekonomike.

## ËSHTË FAJTOR

Sepse nga data e pa vërtetuar e gjerë me datë 28.12.2021, në fshatin Ratkoc komuna e Rahovecit i pandehuri në shtëpinë e tij me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmangë pagesën për shërbime të tilla, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Kosovës, në atë mënyrë që nga kontrolli i ekipeve të zyrtarëve të K tek i pandehuri me nr. unik të njehsorit DGJ..., është hasur se është duke u furnizuar jashtë njehsorit elektrik, në atë mënyrë që energjia elektrike e shpenzuar nuk ishte regjistruar dhe në këtë mënyrë i pandehuri është furnizuar me energji pa matje, me ç' rast të dëmtuarës K-distriktit në Gjakovë i ka shkaktuar dëm material në shumë prej 86.29 euro.

- Me këtë ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Andaj gjykata konform nenit 4, 7, 17, 38, 39,40 46, 47, 48, 49, 69, dhe nenit 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, të njëjtit i'a shqipton:

## DËNIMIN ME KUSHT

Ashtu që e gjykon me dënim burgimi me kusht në kohëzgjatje prej **2 (dy) muajve**, ndërsa gjykata dënimin e shqiptuar nuk do ta ekzekuton në afatin kohor prej **1 (një) viti**, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

E dëmtuara K distrikti Gjakovë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontestin civil.

I akuzuari Xh.M lirohet nga shpenzimet e procedurës penale dhe të njëjtat bijnë në mjetet buxhetore të kësaj gjykatës.

### A r s y e t i m

#### 1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr.1393/2022 të dt. 08.05.2023, e ka akuzuar Xh.M, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar si dhe administrimit të provave, të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 13.05.2024, ku prezent ishin Prokurorja e shtetit Uridia Caka dhe i akuzuari Xh.M, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari Xh.M, në shqyrtimin fillestar është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, për të cilën i vije keq, kërkoj falje, jam i moshuar, jetoj me një pension, po ashtu me gjendje shëndetësore nuk jam mirë, jam në tretman të vazhdueshëm mjekësor, andaj kërkoj nga gjykata që të merren parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, në rastin e shqiptimit të dënimit të më shqiptohet një dënim sa më i butë, ku i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm që të mos kryej kurrfarë vepre penale.

Prokurorja e Shtetit Uridia Caka ka deklaruar: Nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë të bërë nga i akuzuari dhe se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari pranimin e fajësisë e bëri me vullnet të plotë, pa presion dhe pa shtytje nga askush, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallet fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve procedurale.

#### 2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës

gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i Shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

### 3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

-Se i akuzuari Xh.M ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë;

- Procesverbali mbi konstatimin e gjendjes faktike datë 28.12.2021 me nr. 80005797;
- Procesverbali i K 2507156 të dt.15.12.2021;
- Procesverbali nr.2011701 i datës 28.12.2021 në emër të konsumatorit S.M, ndërsa si shfrytëzues Xh.M;
- Procesverbali nr.2038355 i datës 25.02.2023 në emër të konsumatorit S.M, ndërsa si shfrytëzues Xh.M;
- Kalkulimi i RH datë 29.12.2021;
- Fatura mbi dëmin e shkaktuar DGJHP të datës 29.12.2021;
- Foto dokumentacioni si dhe shkresat tjera në lëndë.

### 4. Elementet e veprës penale

Në nenin 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së parashihet: *Për qëllime të këtij neni, vjedhja e shërbimeve të gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes përfshin, por nuk kufizohet në marrjen, përdorimin, devijimin, nxjerrjen ose përfitimin nga ndonjë shërbim i gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes që furnizohet nga ose përmes rrjetit përcues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar, lidhur me: Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet.*

### 5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin Xh.M, e ka shpallur fajtor për veprat penale për të cilat ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitiv të aktgjykimit, formohen të gjitha

elementet e veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenit 69 të KPRK-së (kodi nr. 06/L074), të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit, pranimin e fajësisë, kushtet e dobëta ekonomike, jeton me familjen 4 anëtarëshe, është mbajtës i familjes, merr një pension në shumë prej 100 euro, është në tretman të vazhdueshëm mjekësor, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryej kurrfarë veprë penale, ndërsa duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin me kusht në kohëzgjatje prej **dy (2) muajve burgim**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afat prej **një (1) viti** nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi lirimin e të akuzuarit nga paushalli gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 452 par.4 të KPPK-së për faktin se gjykata konsideron se me pagimin e shpenzimeve do të rrezikohej gjendja materiale e të akuzuarit pasi që jeton me një pension në shumë prej 100 euro dhe është në tretman të vazhdueshëm mjekësor, ku gjykatës ia ka prezantuar raportin mjekësor të lëshuar nga QKUK në Prishtinë me nr. të historisë 869/22 i dt. 21.07.2022.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA RAHOVEC**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**  
**P.nr.2023:105099, dt.13.05.2024.**

**Sekretarja juridike**  
Behije Karaçica

**Gjyqtari i vetëm gjykues**  
Lulzim Paçarizi

**UDHËZIMI JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.